



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE

Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt “Furnizim vendosje kaldaje”

I mbajtur sot në datë 01.08.2024, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt **“Furnizim vendosje kaldaje”**, me fondin limit **32 500 000 (tridhjetë e dy milion e pesëqind mijë) Lekë pa Tvsh.**

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

Së pari, kemi të bëjmë me 1 (një) lloj malli (kaldaja për ngrohje) i destinuar për objekte të paracaktuara, pra nuk ka asnjë arsye apo shkak për ndarjen e procedurës në lote.

Së dyti, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin, ndër të tjera, sigurimin me ngrohje të objekteve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë. Furnizimi dhe vendosja do të realizohet nga kontraktuesi nën monitorimin e autoritetit kontraktor direkt në objektet arsimore sipas planit të shpërndarjes të hartuar nga autoriteti kontraktor në kontratë. Objektet arsimore ku do të instalohen kaldajat ndodhen në territorin të Bashkisë Tiranë dhe shpërndarja e furnizimit dhe instalimit të të njëjtit lloj malli do të sillte kosto shtesë dhe procedura burokratike të panevojshme për autoritetin kontraktor .

Në këto kushte, krijimi i marrëdhënies kontraktore me disa operatorë ekonomikë, ku AK-së do t'i duhet të presë furnizimin e njërit mall nga njëri operator dhe instalimin nga operatori tjetër, sipas loteve, ofron pasiguri, konfuzion, kosto shtesë, vonesa duke vështirësuar në ushtrimin e detyrave të AK-së apo mosrealizim të punëve sipas objektivave.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rëndësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij furnizimi si dhe referuar faktit se kemi të bëjmë me të njëjtin mall, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë, në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për sigurimin dhe shpërndarjen e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

PËRGJEGJËS PËR PROKURIMIN

Klodjan Llubani _____